LIGJ
Nr. 59/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS ZVICERANE PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për mbrojtjen shoqërore sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 21.7.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13843, datë 5.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE NDËRMJET

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

KONFEDERATËS ZVICERANE PËR MBROJTJEN SHOQËRORE

Republika e Shqipërisë

dhe

Konfederata Zvicerane

më poshtë të quajtuara «shtetet kontraktuese»,

të udhëhequra nga dëshira për të rregulluar marrëdhëniet midis dy shteteve në fushën e mbrojtjes shoqërore, kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1
Përkufizime

(1) Në këtë marrëveshje termat e poshtëshënuar përkufizohen si vijon:

a) «Zvicra» nënkupton Konfederatën Zvicerane dhe «Shqipëria» nënkupton Republikën e Shqipërisë;

b) «Legjislacionet» nënkuptojnë ligjet dhe aktet nënligjore të shteteve kontraktuese në fushën e mbrojtjes shoqërore të përcaktuara në nenin 2;

c) «Territor»
- në lidhje me Zvicrën, territori i Konfederatës Zvicerane,
- në lidhje me Shqipërinë, territori i Republikës së Shqipërisë;

d) «shtetas»
- në lidhje me Zvicrën, personat me shtetësi zvicerane,
- në lidhje me Shqipërinë, personat me shtetësi shqiptare;

e) «Anëtarët e familjes», «pasjetuesit» dhe «përfituesit», janë ata persona, të cilët sipas legjislacioneve të zbatueshme kombëtare përcaktohen ose njihen si të tillë;

f) «Periudhat e sigurimit» periudhat e pagesës së kontributit ose periudha të barazvlefshme me to, të cilat njihen si të tilla sipas dispozitave ligjore të secilit shtet kontraktues.

g) «Vendbanim i përhershëm» vendi, në të cilin një person qëndron ose jeton me synimin e qëndrimit të përhershëm;

h) «Vendbanim» vendi, në të cilin një person qëndron zakonisht;

i) «Vendqëndrim» vendi, në të cilin një person qëndron përkohësisht;

j) «Autoriteti kompetent »
- në lidhje me Zvicrën, Zyra Federale për Sigurimet Shoqërore,
- në lidhje me Shqipërinë, Ministri ose Ministrat përgjegjës për dispozitat ligjore të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje.

k) «institucioni kompetent»
- në lidhje me Zvicrën, institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave ligjore të përmendura në Nenin 2,
- në lidhje me Shqipërinë, institucioni përgjegjës për zbatimin e dispozitave ligjore të përmendura në Nenin 2;

l) «Zyra ndërlidhëse» institucioni i caktuar nga autoriteti kompetent i secilit shtet kontraktues për të

garantuar koordinimin, shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen administrative me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshje në institucionet e dy shteteve kontraktuese.
m) «Refugjatët» janë personat sipas Konventës së 28 korrikut 1951 dhe sipas Protokollit të 31 janarit 1967 në lidhje me statusin ligjor të refugjatëve;

n) «Persona pa shtetësi» janë personat pa shtetësi sipas Konventës së 28 shtatorit 1954 mbi statusin ligjor të personave pa shtetësi;

(2) Terma të tjera, të cilat nuk janë përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, e kanë kuptimin sipas legjislacioneve të zbatueshme të shteteve kontraktuese.

Neni 2
Fusha lëndore e zbatimit

(1) Kjo marrëveshje zbatohet në lidhje me legjislacionin në vijim:

A) në Zvicër:
a) në lidhje me ligjin federal të 20 dhjetorit 1946 mbi Sigurimin e Pleqërisë dhe Sigurimin Familjar;
b) në lidhje me ligjin federal të 19 qershorit 1959 mbi Sigurimin e Invaliditetit.

B) në Shqipëri: në lidhje me dispozitat ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore të detyrueshme për:
a) pensionin e pleqërisë;
b) pensionin e invaliditetit;
c) pensionin familjar.

(2) Për sa kohë kjo marrëveshje nuk e parashikon ndryshe, në legjislacionin sipas Paragrafit (1) të këtij neni, nuk bëjnë pjesë as kontrata apo marrëveshje të tjera ndërshtetërore dhe as legjislacionet mbishtetërore në lidhje me sigurimet shoqërore, për të cilat është rënë dakord midis një shteti kontraktues dhe një shteti të tretë në lidhje me mbrojtjen shoqërore dhe as aktet nënligjore të miratuara për zbatimin e tyre.

(3) Kjo marrëveshje zbatohet për të gjitha dispozitat ligjore, të cilat mund të ndryshojnë, plotësojnë, konsolidojnë ose zëvendësojnë legjislacionin e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni, përveç rasteve kur autoriteti kompetent i shtetit kontraktues, i cili ka ndryshuar legjislacionin, e njofton me shkrim autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues brenda 6 muajve pas publikimit zyrtar të legjislacionit të ri, që marrëveshja nuk është e zbatueshme mbi të.

(4) Kjo marrëveshje mund t´u referohet dispozitave të tjera ligjore që paraqesin një kategori të re të përfitimeve të sigurimeve shoqërore, vetëm në rast se shtetet kontraktuese bien dakord për këtë qëllim.

Neni 3
Fusha personale e zbatimit

Kjo marrëveshje vlen:

a) për shtetasit e shteteve kontraktuese, të cilët i nënshtrohen ose i janë nënshtruar legjislacionit të njërit shtet kontraktues, si dhe për anëtarët e familjes dhe pasjetuesit e tyre;
b) për refugjatët dhe personat pa shtetësi, si dhe anëtarët e familjes dhe pasjetuesit e tyre, për sa kohë këta persona jetojnë në territorin e njërit shtet kontraktues; me të drejtën për të zbatuar legjislacionet më të favorshëm kombëtarë,
c) në lidhje me nenet 6-9 dhe nenet 11 dhe 13 dhe nenet 23 dhe 24 për të gjithë personat pavarësisht shtetësisë së tyre.

Neni 4
Trajtimi i barabartë

(1) Nësë kjo marrëveshje nuk parashikon ndryshe, në rastin kur zbatohen dispozitat ligjore të njërit shtet kontraktues, personat e mbuluar nga fusha personale e zbatimit të kësaj Marrëveshje trajtohen në mënyrë të barabartë me shtetasit e atij shteti kontraktues.

(2) Paragrafi (1) nuk është i vlefshëm për dispozitat ligjore zvicerane që kanë lidhje me:
a) Sigurimin vullnetar të pensionit të Pleqërisë, pensionit Familjar dhe të Invaliditetit;
b) Sigurimin për pensionin e Pleqërisë, atë Familjar dhe të Invaliditetit të shtetasve zviceranë, që punojnë jashtë vendit të tyre në shërbim të Konfederatës ose të një organizate të caktuar nga Këshilli Federal;
c) Përfshirjen vullnetare në skemën e detyrueshme të sigurimeve për pension Pleqërie, Familjar dhe Invaliditeti për të punësuarit zviceranë në një organizatë ose institucion të favorizuar sipas nenit 2, paragrafi (1) të Ligjit të Shtetit Pritës, të datës 22 qershor 2007, të cilët gëzojnë privilegje, imunitete dhe lehtësira.

Neni 5
Pagesat e përfitimeve jashtë shtetit

(1) Personat e përmendur në nenin 3 pika (a) dhe (b) të cilët mund të pretendojnë për përfitime në para, sipas legjislacionit të përmendur në nenin 2, do të marrin këto përfitime në masë të plotë dhe pa asnjë kufizim, për aq kohë sa ata të banojnë në territorin e njërit prej Shteteve Kontraktuese. Ky rregull nuk zbatohet për paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.

(2) Pensionet e rregullta të sigurimeve zvicerane të invaliditetit për të siguruarit me shkallën e invaliditetit më pak se 50%, si dhe pensionet e jashtëzakonshme dhe përfitimet për përkujdesje për personat me aftësi të kufizuar të dhëna nga sigurimet zvicerane të pensionit të pleqërisë, pensionit familjar dhe të invaliditetit, u paguhen vetem personave të cilët kanë vendbanimin e përhershëm dhe qëndrimin e zakonshëm në Zvicër.

(3) Pensioni social i paguar nga skema e detyrueshme shqiptare e sigurimeve shoqërore u paguhet vetëm personave sipas paragrafëve (g) dhe (h) të nenit 1 të kësaj Marrëveshje.

(4) Përfitimet në para në përputhje me legjislacionin e njërit shtet kontraktues, referuar në nenin 2 të kësaj marrëveshjeje, do u paguhen shtetasve të vendit tjetër kontraktues që banojnë në një shtet të tretë, si dhe anëtarëve të familjes dhe pasjetuesve të tyre me të njëjtat kushte dhe me të njëjtën masë si dhe shtetasve të vetë këtij shteti dhe anëtarëve të familjes dhe pasjetuesve të tyre, që banojnë në këtë shtet të tretë.

KREU II
Legjislacioni i zbatueshëm

Neni 6
Parimet e përgjithshme

Me përjashtim të rasteve kur kjo marrëveshje parashikon ndryshe, një person, i cili është duke ushtruar veprimtari si i punësuar apo vetëpunësuar në territorin e njërit shtet kontraktues, për çdo veprimtari i nënshtrohet legjislacionit të shtetit kontraktues, në të cilin ushtron veprimtarinë si i punësuar apo vetëpunësuar.

Neni 7
Persona të dërguar

(1) Nëse një person, i cili është punësuar në territorin e njërit shtet kontraktues, nga punëdhënësi i tij me seli në po atë shtet kontraktues dërgohet përkohësisht në territorin e shtetit tjetër kontraktues, atëherë ky person vazhdon ti nënshtrohet ekskluzivisht legjislacionit të këtij shteti, sikur të ishte i punësuar aty, me kusht që kohëzgjatja e punësimit të jetë jo më shumë se 24 muaj.

(2) Për të dëshmuar dërgimin sipas paragrafit (1) të këtij neni lëshohet një konfirmim sipas marrëveshjes administrative.

Neni 8
Të punësuarit në kompanitë e transportit ajror që veprojnë në rang ndërkombëtar

Personat, të cilët punësohen në territorin e të dy shteteve kontraktuese si anëtarë të ekuipazhit të ndërmarrjeve të transportit ajror, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues, në të cilin ndërmarrja ka selinë e saj, përveç rasteve kur janë të punësuar në një filial, degë komerciale ose përfaqësim të përhershëm të kësaj ndërmarrjeje në territorin e shtetit tjetër kontraktues.

Neni 9
Të punësuarit në kompanitë detare

1. Për ekuipazhin e një anijeje detare, e cila mban flamurin e njërit shtet kontraktues, vlen vetëm

legjislacioni i atij shteti kontraktues. Për zbatimin e këtij neni, një veprimtari, e cila kryhet në bordin e një anijeje detare, e cila mban flamurin e njërit shtet kontraktues, konsiderohet e barazvlefshme me veprimtarinë që ushtrohet në territorin e po atij shteti kontraktues.

2. Ky rregull nuk zbatohet për persona si punëtorët e portit, të cilët shkojnë në bord për të kryer punë në një anije të ankoruar në port.

Neni 10
Anëtarët e përfaqësive diplomatike ose konsullore

(1) Kjo marrëveshje nuk ndikon në zbatimin e dispozitave të Konventës së Vjenës të 18 prillit 1961 mbi marrëdhëniet diplomatike dhe të Konventës së Vjenës të 24 prillit 1963 mbi marrëdhëniet konsullore.

(2) Shtetasit e njërit shtet kontraktues, të cilët janë dërguar si anëtarë të një përfaqësie diplomatike apo konsullare në territorin e shtetit tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit të shtetit kontraktues i cili i ka dërguar.

(3) Shtetasit e njërit shtet kontraktues, të cilët në territorin e shtetit tjetër kontraktues punësohen në shërbim të një përfaqësie diplomatike apo konsullore të shtetit të parë kontraktues, janë të siguruar sipas legjislacionit të shtetit të dytë kontraktues. Ata mund të zgjedhin zbatimin e legjislacionit të shtetit të parë brenda tre muajve pas fillimit të veprimtarisë së tyre ose pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje.

(4) Paragrafi (3) i këtij neni zbatohet edhe për shtetasit e njërit shtet kontraktues, të cilët janë të punësuar në shërbim personal dhe privat të anëtarëve të një përfaqësie diplomatike apo konsullore.

(5) Nëse një përfaqësi diplomatike apo konsullore e njërit shtet kontraktues në territorin e shtetit tjetër kontraktues, punëson persona të cilët janë të siguruar sipas legjislacionit të këtij shteti kontraktues, atëherë ajo duhet të plotësojë detyrimet, të cilat i përcakton legjislacioni për punëdhënësit të këtij shteti kontraktues. E njëjta vlen për shtetasit e përmendur në paragrafet (2) dhe (3), të cilët i punësojnë këta persona në shërbimin e tyre personal.

(6) Paragrafet (2)-(5) të këtij neni, nuk vlejnë për konsujt e nderit të përfaqësive konsullore dhe të punësuarit e tyre.

(7) Shtetasit e njërit shtet kontraktues, të cilët në territorin e shtetit tjetër kontraktues punësohen në shërbim të një përfaqësie diplomatike apo konsullore të një shteti të tretë dhe të cilët nuk janë të siguruar nga ky shtet dhe as në shtetin e tyre amë, do të sigurohen sipas legjislacionit të shtetit kontraktues, në territorin e të cilit ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Ky rregull vlen në mënyrë analoge për bashkëshortin si dhe fëmijët, të cilët jetojnë me personin e siguruar.

Neni 11
Nëpunësit civil

Nëpunësit civil si dhe personat e trajtuar si të tillë të njërit shtet kontraktues, të cilët dërgohen në territorin e shtetit tjetër kontraktues, i nënshtrohen legjislacionit te shtetit kontraktues, të cilit i përket administrata që i punëson.

Neni 12
Përjashtime

Autoritetet kompetente, me marrëveshje me shkrim, mund të bien dakord për përjashtime nga nenet 6-11 për individë ose grupe të caktuara të personave.

Neni 13
Anëtarët e familjes

(1) Nëse një person sipas neneve 7-12 gjatë veprimtarisë fitimprurëse në territorin e njërit shtet kontraktues vazhdon t'i nënshtrohet legjislacionit të shtetit tjetër kontraktues, atëherë kjo vlen edhe për bashkëshortin/en dhe fëmijët, të cilët gjenden së bashku me të në shtetin e parë kontraktues, për sa kohë ata vetë nuk ushtrojnë një veprimtari fitimprurëse.

(2) Nëse sipas paragrafit (1) të këtij neni për bashkëshortët dhe fëmijët, të cilët me personin e punësuar gjenden në territorin e Shqipërisë dhe nuk ushtrojnë veprimtari fitimprurëse, vlen legjislacioni zviceran, atëherë edhe ata janë të siguruar në Sigurimin e Pensionit të Pleqërisë, Familjar dhe Invaliditetit.

KREU III
Dispozitat për përfitimet

A.Dispozitat për përfitimet zvicerane

Neni 14
Masat rehabilituese

(1) Shtetasit shqiptarë të cilët menjëherë para fillimit të invaliditetit, u nënshtrohen detyrimeve kontribuese në sistemin Zviceran të Sigurimit për Pension Pleqërie, Pension Familjar dhe Invaliditet, kanë të drejtë për të përfituar masa rehabilituese për aq kohë sa ata qëndrojnë në Zvicër.

(2) Shtetasit shqiptarë, që nuk janë në marrëdhënie pune dhe të cilët në rastin e shfaqjes së invaliditetit nuk i plotësojnë kushtet paraprake që kanë lidhje me moshën, për derdhjen e kontributeve të detyrueshme në Sigurimin zviceran të Pensionit të Pleqërisë, Familjar dhe Invaliditetit, por që janë të siguruar atje, kanë të drejtën për të përfituar masa rehabilituese përsa kohë që kanë vendbanimin e përhershëm në Zvicër, nëse menjëherë para shfaqjes së invaliditetit kanë qëndruar të paktën një vit në mënyrë të pandërprerë në Zvicër. Fëmijëve të mitur, përveç kësaj iu takon e drejta për masa të tilla, nëse kanë vendbanimin e përhershëm në Zvicër dhe ose

kanë lindur atje si invalid ose që prej lindjes kanë jetuar atje pandërprerje.

(3) Shtetasve shqiptarë me vendbanim në Zvicër, të cilët largohen nga Zvicra për jo më shumë se tre muaj, kjo periudhë nuk u konsiderohet si ndërprerje e qëndrimit të tyre në Zvicër sipas paragrafit (2).

4) Fëmijët, të cilët kanë lindur invalid në Shqipëri dhe nëna e të cilëve gjatë shtatzanisë së saj ka qëndruar në Shqipëri gjithsej jo më shumë se dy muaj duke ruajtur vendbanimin në Zvicër, trajtohen në mënyrë të barabartë me fëmijët e lindur invalidë në Zvicër. Sigurimi zviceran i invaliditetit në rastin e lindjes së fëmijës me aftësi të kufizuar merr përsipër shpenzimet e krijuara për tre muajt e parë pas lindjes në Shqipëri deri në atë masë, sa do të ishte i detyruar të mbulojë në Zvicër për këto shërbime. Fjalia e parë dhe e dytë ka kuptim dhe për fëmijët, të cilët kanë lindur invalid jashtë territorit të shteteve kontraktuese dhe sigurimi zviceran i invaliditetit në një rast të tillë merr përsipër shpenzimet e paraqitura jashtë shtetit vetëm nëse masat duhej të ndërmerreshin menjëherë për arsye të gjendjes së fëmijës.

Neni 15
Bashkimi i periudhave të sigurimit

(1) Në qoftëse një person nuk i plotëson kushtet për të drejtën për pension të sigurimit të invaliditetit, të përcaktuar me legjislacionin zviceran, vetëm në bazë të periudhave të sigurimit të realizuara sipas legjilacionit zviceran, atëherë institucioni kompetent i sigurimit për fitimin e të drejtës për këto përfitime do të marrë parasysh periudhat e sigurimit të cilat janë realizuar në bazë të legjislacionit shqiptar si dhe periudhat e barazvlefshme me to, në qoftëse ato nuk mbivendosen me periudhat e realizuara sipas legjislacionit zviceran.

(2) Në qoftëse një person i përmendur në nenin 3, paragrafi (1) edhe duke aplikuar paragrafin (1) të këtij neni, nuk i plotëson kushtet për të drejtën për përfitim pensioni, atëherë institucioni zviceran merr parasysh edhe periudhat e sigurimit dhe periudhat e barazvlefshme me to të realizuara në ndonjë vend të tretë me të cilin Zvicra ka një marrëveshje për sigurimet shoqërore, që parashikon bashkimin e periudhave të sigurimit për të drejtën për pension të rregullt të sigurimit të invaliditetit Zviceran.

(3) Nëse periudhat e sigurimit që janë përmbushur sipas legjislacionit zviceran, nuk arrijnë një vit, atëherë paragrafet (1) dhe (2) nuk zbatohen.

(4) Për llogaritjen e përfitimit merren parasysh vetëm periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit zviceran. Përcaktimi i përfitimit bëhet në bazë të legjislacionit zviceran.

Neni 16
Kompensimi i njëhershëm

(1) Shtetasit shqiptarë dhe pasjetuesit e tyre që ndodhen në kushte të njëjta sikurse shtetasit zviceranë dhe pasjetuesit e tyre kanë të drejtën të përfitojnë pensione të rregullta dhe shtesa për ndihmë dhe përkujdesje nga Sigurimi Zviceran i Pensionit të Pleqërisë dhe Familjar. Bëjnë përjashtim paragrafët (2)-(5) të këtij neni.

(2) Nëse shtetasit shqiptarë ose pasjetuesit e tyre, të cilët nuk banojnë në Zvicër, kanë të drejtë për një pension të pjesshëm të rregullt, shuma e të cilit është maksimumi dhjetë përqind e

pensionit të plotë të rregullt, atëherë në vend të pensionit të pjesshëm, u paguhet një shumë e njëhershme e llogaritur në vlerën e aktualizuar të pensionit sipas legjislacionit zviceran. Nëse shtetasit shqiptarë ose pasjetuesit e tyre, të cilët kanë përfituar një pension të tillë të pjesshëm, largohen nga Zvicra përfundimisht, atëherë atyre po ashtu do t'u akordohet një pagesë e njëhershme, e cila i korrespondon vlerës së aktualizuar të pensionit në momentin e largimit nga vendi.

(3) Nëse pensioni i pjesshëm i rregullt arrin shifrën më shumë se dhjetë përqind, por maksimumi njëzetë përqind të një pensioni të plotë të rregullt, atëherë shtetasit shqiptarë dhe pasjetuesit e tyre, të cilët nuk banojnë në Zvicër ose të cilët largohen përfundimisht nga Zvicra, mund të zgjedhin ndërmjet pagesës së rregullt të pensionit ose një shume të njëhershme. Përzgjedhja duhet bërë gjatë procesit të llogaritjes së pensionit, nëse personi në momentin që i lind e drejta për përfitim, jeton jashtë Zvicrës, ose në momentin e largimit nga Zvicra, në qoftë se personi përfitonte tashmë një pension në Zvicër.

(4) Nëse në rastin e një çifti bashkëshortësh, të dy bashkëshortët kanë qenë të siguruar në sigurimin zviceran, atëherë shuma njëhershme i paguhet njërit bashkëshort, vetëm nëse edhe tjetri bashkëshort gjithashtu ka të drejtë për pension.

(5) Pas pagesës së shumës së njëhershme nga sigurimi zviceran, nuk mund të ngrihen më pretendime për përfitime nga këto sigurime lidhur me pagesat e kontributeve të mëparshme.

(6) Përmbajtja e paragrafëve (2)-(5) të këtij neni vlen edhe për pensionet e rregullta të sigurimit të invaliditetit zviceran, nëse personi me të drejtën për pension e ka mbushur moshën 55 vjeç dhe nëse në rastin e tij/saj nuk parashikohet të kryhen verifikime të mëtejshme për plotësimin e kushteve të invaliditetit.

Neni 17
Pensionet e jashtëzakonshme

(1) Shtetasit shqiptarë kur plotësojnë të njëjtat kushte me shtetasit zviceranë, kanë të drejtën për një pension të jashtëzakonshëm familjar, një pension të jashtëzakonshëm invaliditeti ose një pension të jashtëzakonshëm të pleqërie i cili zëvendëson një pension të jashtëzakonshëm familjar ose të jashtëzakonshem invaliditeti, nëse personi në fjalë menjëherë para momentit kur ai kërkon pension, ka banuar në Zvicër për të paktën pesë vite të plota pa ndërprerje.

(2) Kohëzgjatja e banimit në Zvicër, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, vlen si e pandërprerë, nëse personi në fjalë nuk largohet nga Zvicra brenda një viti kalendarik për më shumë se tre muaj. Në raste të veçanta ky afat mund të zgjatet. Ndërsa periudhat, gjatë të cilave shtetasit shqiptarë që banojnë në Zvicër, kanë qenë të cliruar nga sigurimi zviceran i pleqërisë, sigurimi familjar dhe ai i invaliditetit, nuk llogariten si në kohëzgjatjen e qëndrimit në Zvicër.

(3) Rimbursimi i kontributeve të paguara në sigurimin zviceran të pleqërisë dhe atë familjar, si dhe pagesa/kompensimet e njëhershme sipas nenit 16, paragrafet (2)-(6), nuk janë në kundërshtim me dhënien e pensioneve të jashtëzakonshme sipas paragrafit (1) të këtij neni; por në këto raste, kontributet që janë rimbursuar ose pagesat e njëhershme të paguara tashmë do të përllogariten në pensionet e ardhshme që do të akordohen.

B. Dispozitat për përfitimet shqiptare

Neni 18
Bashkimi i periudhave të sigurimit dhe përllogaritja e përfitimeve

(1) Nëse një person nuk i plotëson kushtet për realizimin e të drejtës për përfitime, vetëm në bazë të periudhave të sigurimit të realizuara sipas legjislacionit shqiptar, atëherë me qëllim për të përmbushur periudhën minimale të sigurimit të nevojshme për tu pajisur me të drejtën për përftime, do të merren në konsideratë edhe periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit zviceran, me kusht që këto periudha të mos mbivendosen me periudhat e sigurimit shqiptar.

(2) Nëse periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit shqiptar nuk arrijnë një vit, atëherë paragrafi (1) nuk zbatohet.

(3) Për llogaritjen e përfitimit merren parasysh vetëm periudhat e sigurimit të realizuara sipas legjislacionit shqiptar. Përcaktimi i përfitimit bëhet sipas legjislacionit shqiptar.

(4) Nëse e drejta për përftim kushtëzohet nga përmbushja e periudhave të sigurimit në një profesion apo punë të caktuar atëherë, periudhat e sigurimit të plotësuara sipas legjislacionit zviceran në këtë profesion apo punë të caktuar, merren në konsideratë sikur të jenë plotësuar në Shqipëri.

(5) Nëse e drejta për përfitime kushtëzohet me përmbushjen e periudhave të sigurimit brenda një harku kohor të caktuar, atëherë periudhat e sigurimit të realizuara brenda harkut kohor të caktuar sipas legjislacionit zviceran, do të konsiderohen sikur janë realizuar në Shqipëri.

Neni 19
Periudhat e sigurimit sipas legjislacionit të shteteve të treta

Nëse një person sipas legjislacionit shqiptar dhe duke marrë në konsideratë periudhat e sigurimit të të dy shteteve kontraktuese sipas nenit 18, nuk ka të drejtë për përfitime, atëherë për përcaktimin e të drejtës për përfitime do të konsiderohen edhe periudhat e sigurimit sipas legjislacionit të shteteve të treta, me të cilët Shqipëria ka marrëveshje mbi sigurimin shoqëror, e cila parashikon bashkimin e periudhave të sigurimit.

KREU IV
Dispozita të ndryshme

Neni 20
Masa administrative

(1) Autoritetet kompetente të dy shteteve kontraktuese:

a) bien dakord për një marrëveshje administrative, marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe përcaktojnë zyrat ndërlidhëse;

b) e njoftojnë njëri-tjetrin reciprokisht mbi të gjitha masat që ndërmerren për zbatimin e kësaj marrëveshje;

c) e njoftojnë njëri-tjetrin reciprokisht në kohën më të shkurtër të mundshme mbi të gjitha ndryshimet legjislative, të cilat mund të ndikojnë në zbatimin e kësaj marrëveshje.

(2) Institucionet kompetente me marrëveshje të dyanshme, mund të zbatojnë procedurat për shkëmbimin e të dhënave në mënyrë elektronike, duke përfshirë të dhënat mbi vdekjen e personave që kanë pasur të drejtën për përfitime, për të racionalizuar zbatimin e kësaj marrëveshje dhe akordimin e përfitimeve.

Neni 21
Ndihma administrative

Autoritetet kompetente, institucionet kompetente dhe zyrat ndërlidhëse i ofrojnë ndihmë njëra-tjetrës në kuadrin e kompetencave të tyre përgjatë zbatimit të marrëveshjes. Kjo ndihmë është falas, për aq kohë sa autoritetet dhe institucionet kompetente të shteteve kontraktuese nuk kanë rënë dakord për asgjë tjetër.

Neni 22
Dispozitat lidhur me përfitimet nga invaliditeti

(1) Për të vlerësuar/matur shkallën e humbjes të aftësisë për punë ose shkallën e invaliditetit në lidhje me caktimin e një pensioni invaliditeti, institucioni kompetent i secilit shtet kontraktues ndërmerr një vlerësim sipas legjislacionit të atij shteti.

(2) Me qëllim të zbatimit të paragrafit (1) të këtij neni, institucioni kompetent i shtetit kontraktues, në territorin e të cilit jeton personi kërkues për përfitim, i ofron në dispozicion falas institucionit kompetent të shtetit tjetër kontraktues, evidencat mjekësore dhe dokumentacionin që ka në administrim; duke marrë parasysh legjislacionin e brendshëm në lidhje më konfidencialitetin mjekësor.
Kur paraqitet një kërkesë për përfitim pensioni, institucioni i shtetit ku i siguruari ka vendbanimin e përhershëm, i dërgon falas institucionit të shtetit tjetër kontraktues formularin e dakordësuar (raportin mjekësor).

(3) Nëse institucioni kompetent i njërit shtet kontraktues kërkon një kontroll mjekësor shtesë për një person, i cili kërkon apo merr përfitime, atëherë institucioni kompetent i shtetit tjetër, do të realizojë kontrollin e kërkuar në territorin në të cilin jeton personi në fjalë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe shpenzimet e ekzaminimeve që aplikohen në vendin e vendbanimit. Institucioni kompetent, i cili ka kërkuar kontrollin, do të kompensojë kostot e tij kundrejt paraqitjes së një fature të detajuar dhe dokumentacionit mbështetës. Procedurat mes institucioneve kompetente do të përcaktohen në marrëveshjen administrative.
Institucioni kompetent që bën kërkesën, ka të drejtën të nxisë kryerjen e diagnostikimit mjekësor nëpërmjet një mjeku ose mjekeje të cilin e zgjedh vetë.

Neni 23
Parandalimi i marrjes së përfitimeve të paligjshme

(1) Autoritetet kompetente të të dyja shteteve kontraktuese angazhohen të parandalojnë dhe luftojnë mashtrimet dhe abuzimet në fushën e kontributeve dhe përfitimeve të pensioneve të pleqërisë, pensioneve familjare dhe pensioneve të invaliditetit, veçanërisht përsa i përket vendbanimit të përhershëm real, gjëndjes civile, numrit të pasardhësve, verifikimit të njohjes së atësisë në gjendjen civile, llojit dhe kohëzgjatjes së arsimimit si dhe ndjekjes konsekuente të